



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 36, datë 16.07.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJEVE TË NDËRTIMIT PËR OBJEKTET:

“STRUKTURA SHËRBIMI NË STACIONET E PLAZHIT”.

ME VENDNDODHJE NË BASHKITË: SHKODËR, KAVAJË, RROGOZHINË, FIER,
VLORË, HIMARË DHE SARANDË

Në mbështetje të Nenit 28, pika 1, dhe 41, pika 1/1, të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Nenit 19, pika 3, shkronja “ç”, të VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, e ndryshuar, VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 62, datë 28.01.2025 “Për përcaktimin e procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e aplikimeve, brenda Brezit Bregdetar”, me propozim të subjekteve zhvilluese, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:


1. Miratimin me kusht të Lejeve të Ndërtimit për: “22 Struktura shërbimi në stacionet e plazhit, me vendndodhje në Bashkitë: Shkodër, Kavajë, Rrogozhinë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë”.
2. Harta e vendndodhjes së strukturave të shërbimit në stacionet e plazhit, sipas territorit administrativ të secilës bashki, bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejeve të Ndërtimit, të shoqëruara nga projekti arkitektonik, i jepen subjekteve zhvilluese veçmas për secilën strukturë shërbimi në stacionin e plazhit, vetëm pas depozitimit të kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve, të nënshkruara mes subjekteve dhe NJVV-ve përkatëse.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 28.07 2025